



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 9.10.2023, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit, (LDK), Trieria Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Berna Saraçi (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajšhori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), , Gresa Lahu (PDK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja (NISMA), Agim Kuleta (LB) dhe Fehmi Kupina (i pavarur).

Munguan: Berat Lahu (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV) dhe Bahri Gashi (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Vigan Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Arben Kçira, përfaqësues nga Zyra ligjore, Osman Bllaca, përfaqësuesi i ambasadës japoneze, z. Yamanak, përfaqësues të OJQ-ve, të KFOR-it dhe të medieve.

FaqeInga12

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit.

Para se të kalohej në diskutim për pikat e rendit të ditës, kryesuesi i njoftoi të pranishmit për prezencën e z. Yamanaka, nga Ambasada japoneze në Kosovë, i cili me ftesën e kryetarit, Përparim Rama, ishte i pranishëm në Kuvendin e Kryeqytetit.

Kryesuesi falënderoi z. Yamanaka për punën e tij të palodhshme dhe të popullit japonez që po bëjnë për popullin e Kosovës.

Gjithashtu, ai bëri të ditur se anëtar i ri i Kuvendit është z. Edmond Azemi nga LVV, i cili e zëvendëson asamblistin Rashit Gashi.

Edmond Azemi e bëri betimin para Kuvendit.

Përparim Rama, kryetar, propozoi që në rend të ditës të futet pika "Propozimi për emërtimin e parkut të lagjes "Arbëria" me emrin e ish- kryeministrit të ndjerë japonez, z. Shinzo Abe.

Po ashtu, falënderoi edhe familjen Abe, posaçërisht znj. Akie Abe, të cilët kanë pranuar që ne ta emërtojmë këtë park me emrin Shinzo Abe.

Gëzim Sveçla tha se për mungesën tonë që nga mbledhja e qershorit, arsyet juridike pse nuk kemi qenë të pranishëm vazhdojnë të qëndrojnë edhe sot. Siç e dini të gjithë, në gjykatat e vendit është duke u zhvilluar një kontest gjyqësor në mes të MAPL dhe Komunës së Prishtinës, në lidhje me seancën e pestë të këtij Kuvendi. Në vlerësimin e MAPL-së ajo seancë nuk ka prodhuar efekte juridike, ndërkohë që ndryshe mendon Komuna e Prishtinës, kështu që aspekti ligjor vazhdon të mbetet kontestues për ne dhe ne nuk do të marrim pjesë në votim në asnjë nga pikat e rendit të ditës, do të diskutojmë, do të debatojmë, por nuk do të votojmë. Më pas shtoi se, kjo qasje jona nuk ka të bëjë fare me emrin e përveçëm të asamblistit Bajçinovci, kemi problem me procedurën e zgjedhjes së tij kryesues i Kuvendit, andaj deri në një vendim të gjykatës, ai vazhdon të mbetet për ne vetëm asamblisti Bajçinovci.

Prandaj për ta ndërperë këtë paligjshmëri, për të vepruar në drejtim të rikthimit në normalitet dhe në atmosferë të punës, grupi i asamblistëve të LVV-së, propozon që të mos vazhdojmë këtë seancë, të mos ftohet seancë tjetër deri në një vendim të plotfuqishëm të gjykatës.

Fehmi Kupina tha se propozimi dhe zgjedhja ime si kryesues i Kuvendit të Kryeqytetit nuk ishte asgjë tjetër, përveçse një sukses i punës së deritashme në politikë dhe në shërbim të qytetarëve, për më shumë se 20 vjet, andaj dhe për mua mbetet shqetësim luhatja politike e udhëheqësve kryesorë të Prishtinës dhe fuqia politike e individëve të instaluar nga politika, fuqi kjo që tejkalon të gjitha. Kundërshtoj hapur si dhe përmes procedurave të rregullta ligjore, mënyrën e funksionimit të këtij Kuvendi dhe këtij ekzekutivi. Kuvendi komunal është organi më i lartë për Komunë dhe i pavarur nga ndërhyrja e mekanizmave tjerë, posaçërisht nga kryetari i Komunës. Kundërshtoj mënyrën e shkarkimit tim në një mbledhje të parregullt, të thirrur nga kryetari i Komunës dhe me insistimin e tij. Kjo formë e funksionimit të Kuvendit është e papranueshme, kundër kushtetuese dhe antiligjore.

Kryesuesi tha se meqë përfaqësuesi nga ambasada japoneze ka të parapara disa takime të tjera, nëse pajtohemi të gjithë, "Propozim-vendimi për emërtimin e parkut në lagjen "Arbëria" me emrin e ish-kryeministrit japonez "Shinzo Abe", të jetë pikë e parë e rendit të ditës.

Gëzim Sveçla propozoi që të bëhet shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, që pika e propozuar nga kryetari Rama, "Propozim-vendimi për emërtimin e parkut në lagjen "Arbëria" me emrin e ish-kryeministrit japonez "Shizo Abe", të jetë pikë e parë e rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 38 vota për dhe 2 abstenime, Propozim-vendimi për emërtimin e parkut në lagjen "Arbëria" me emrin e ish-kryeministrit japonez "Shinzo Abe", kalon në pikën e parë të rendit të ditës.

Z. Yamanaka, përfaqësues nga Ambasada japoneze në Kosovë, falënderoi të pranishmit për emërtimin e këtij parku me emrin e ish-kryeministrit japonez, z. Abe. Ai në vazhdim tha se ne do të vazhdojmë të punojmë së bashku, do t'iu mbështesim në shtetndërtim, do të punojmë me të gjitha partitë politike. Ky park do të jetë një monument shumë simbolik i miqësisë së vendeve tona.

Triera Kasumi-Berisha ngriti shqetësim rreth premtimeve të kryetarit Rama, duke thënë se premtimet e tij në realitet nuk po realizohen. Një nga premtimet e tij ishte edhe "Prishtina me karakter unik në botë", e që vërtetë nuk ka qytet në botë që ka më shumë qen endacakë, që rrezikojnë jetën e qytetarëve. Po ashtu, nuk ka qytet në botë që kundërmon më shumë nga mbeturinat etj. Pavarësisht të gjithave këtyre që u cekën, kulmin e veçantisë e kemi arritur me seancat e jashtëligjshme dhe me vendimet e këtyre seancave. Ripropozoj propozimin e z. Sveçla, që të mos vazhdojë kjo seancë deri në një vendimin final të gjykatës. **Feim Osmani** tha se mbajtja e këtyre seancave është e pakuptimtë, po na sillni në pozicion para një mysafiri shumë të respektuar, me gabime që ju herë pas here i bëni me qëllim. Këto nuk janë gabime, po është qëllim i juaji, i udhëheqjes, andaj iu kisha lutur t'i ktheheni realitetit dhe të mos bëni lojëra të tilla, sepse për mua janë të turpshme dhe unë s'mund të bëhem pjesë e këtyre paqartësive juridike.

Kushtrim Mushica theksoi se ne si GP i AAK-së, ju bëjmë thirrje që të ndalni këto veprime dhe të respektoni ligjshmërinë, në mënyrë që deri në një vendimin fuqiptotë të gjykatës, ministritë përkatëse nuk e shqyrtojnë asnjë vendim të Komunës së Prishtinës. Mendojmë se sipas kësaj, nuk ka asnjë bazë ligjore të mbahet kjo seancë. Andaj ne si grup i Aleancës nuk e shohim të arsyeshme të vazhdojmë të qëndrojmë në një mbledhje si kjo.

Pas diskutimit të z. Mushica, përfaqësuesit e GP të AAK-së e lështuan mbledhjen.

Arianit Beqiri tha se ne si GP i LVV-së, qëndrojmë prapa propozimit të shefit tonë të grupit z. Gëzim Sveçla.

Gëzim Mehmeti, propozoi që deri në aktgjykimin e prerë, i cili do të jetë i respektueshëm, mbledhjet t'i udhëheq asamblisti më i moshuar i Kuvendit, pa marrë parasysh se cilit subjekt politik i takon, kështu do e kishim zgjedhur këtë ngërç politik në të cilin jemi në Kuvendin e Prishtinës, ky është propozimi im konkret për votim.

Faton Zeka, kërkoi nga ekzekutivi i Komunës së Prishtinës, që të mos vazhdohet me mbajtjen e këtyre mbledhjeve të paligjshme, sepse është duke u rrezikuar rendi kushtetues i Republikës së Kosovës.

Kryesuesi tha se kryetari Përparim Rama, ka propozuar që pika e dytë e rendit të ditës: "Raportimi i Kryetarit të kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronave komunale për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, të kalojë në pikën e 14-të, për arsye se ai do të kthehet dhe do ta paraqesë arsyetimin e kësaj pike.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e z. Rama.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota, pika e 2 kalon si pikë e 14-të e rendit të ditës.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e z. Sveçla, për ndërprerjen e kësaj seance dhe vazhdimin e saj në kushtet kur proceset gjyqësore janë afër apo dhe do ta kemi një verdikt final.

Kryesuesi konstatoi se më 14 vota për dhe 26 kundër, nuk miratohet propozimi i z. Sveçla për ndërprerjen e seancës.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Propozim-vendimi për emërtimin e parkut në lagjen "Arbëria" me emrin e ish-Kryeministrit japonez Shinzo Abe;
2. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së gjashtë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit;
3. Propozim-vendimi për arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo" dhe realizimin projekteve që dalin nga marrëveshja për realizimin e projekteve "Solar4Kosovo";
4. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Redon (Nuredin) Bajramit;
5. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Afrim (Zenel) Mehmetit, Jakup (Ejup) Ismailit, Bajram (Ibish) Gashit dhe Jahi (Mejdi) Ramadanit;
6. Propozim-venndimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri (Rifat) Hoxhës dhe Besnik (Halit) Asllanit;

7. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Adem (Hazir) Berishës, Hetem (Hazir) Berishës, Fadil (Hazir) Berishës dhe Rustem (Hazir) Berishës;
8. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Qamil (Ismet) Bullatovcit, Agron (Ismet) Bullatovcit, Bajram (Muharrem) Bullatovcit dhe Bujar (Muharrem) Bullatovcit;
9. Propozim-vendimi për këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Besim (Lika) Namanit, Naim (Isa) Berishës, Halil Blakçorit, Zymer (Ismi) Berishës, Ilmi (Izmi) Berishës, Shaqir (Salih) Eminit, Milot (Isuf) Berishës, Fitim (Izmi) Berishës, Hatixhe (Bajram) Oranit, Neron (Isuf) Berishës, Alban (Feriz) Blakçorit, Florim (Omer) Gashit, Ilir (Omer) Gashit, Nazife (Bajram) Namanit dhe Shefkije (Bajram) Blakçorit;
10. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore "Pranvera shqiptare 81";
11. Informatë për gjendjen në institucionet shëndetësore (QKMF, QMU, QMF);
12. Informatë lidhur me përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollor 2023-2024;
13. Propozim-vendimi për caktimin e komisionit për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës;
14. Raportimi i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronave komunale për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023;
15. Pyetje dhe përgjigje
16. Të ndryshme.

Pika e parë

Propozim-vendimi për emërtimin e parkut në lagjen "Arbëria" me emrin e ish-Kryeministrit japonez Shinzo Abe.

Kryesuesi konstatoi se më 40 vota për, u miratua Vendimi për emërtimin e parkut në lagjen "Arbëria" me emrin e ish-Kryeministrit japonez "Shinzo Abe".

Pika e dytë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së gjashtë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për, u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së gjashtë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e tretë

Propozim-vendimi për arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo" dhe realizimin e projekteve që dalin nga marrëveshja për realizimin e projekteve diellore "Solar4Kosovo".

Arsyetimin për këtë pikë të rendit të ditës e paraqiti Mimoza Sylejmani, drejtore.

Gëzim Sveçla tha se kjo marrëveshje ka kosto për Komunën e Prishtinës, andaj kërkoj të dijë se cila është vlera e kostos, sa është afati për realizimin e saj, a është e planifikuar për buxhetin e vitit të ardhshëm.

Milazim Vitija tha se këtu kemi të bëjmë me një marrëveshje në mes të dy komunave për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo".

Me anë të kësaj marrëveshjeje, qytetarët e Obiliqit do të mund të shfrytëzojnë 40 MW energji termike përmes projektit të dyfishimit të kapaciteteve, i cili do të sigurojë 140 MW energji për Prishtinën.

Kujtojmë që projekti "Solar4Kosovo" është projekti më i madh i ngrohjes qendrore nga sistemi diellor në ballkan dhe lokacioni i ndërtimit të këtij impianti është në qytetin e Obiliqit, përkatësisht në fshatin Shkabaj.

Ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim për votim.

Gzim Mehmeti tha se ky projekt do të mundësoj rritjen e kapacitetit të ndërmarrjes "Termokos", për të zgjeruar rrjetin e ngrohjes qendrore edhe në lagjet me banim individual. Mendoj se është pak shqetësuese se ky projekt pa një miratim në Parlamentin e Kosovës, do të jetë vetëm projekt në fjalë.

Leutrim Retkoceri theksoi se ky projekt është i mirëseardhur, është projekt i rëndësishëm, andaj uroj që pas vendosjes së solarëve, të ndikojë në zbutjen e krizës së energjisë në Republikën e Kosovës dhe uljen e çmimit, për të çka qytetarët e komunës së Prishtinës e paguajnë më së shumti e më së shtrenjti.

Kryesuesi kërkoi nga të pranishmit që diskutimet e tyre të jenë në kuadër të pikës të rendit të ditës, e jo të diskutohet për çështje të tjera që nuk janë në rend të ditës.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Sveçla, sqarime të nevojshme dha Valbona Makolli, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, u miratua Vendimi për arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo" dhe realizimin e projekteve që dalin nga marrëveshja për realizimin e projekteve diellore "Solar4Kosovo".

Pika e katërt

ropozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Redon (Nuredin) Bajramit.

Arsyetimin për këtë pikë të rendit të ditës e paraqiti Doruntinë Maloku, drejtore,

Nora Kelmendi, tha se, sa i përket propozim-vendimit dhe vendimit, sipas Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, është kthyer përgjigje për destinimin e parcelës nr. 930205 dhe sipas tyre ky destinim i kësaj prone është infrastrukturë rrugore – brez i gjelbër, jo ndërtim, ashtu siç është cekur tani në vendim dhe kërkoi që kjo të korrigohet.

Lidhur me çështjen e ngritur nga znj. Kelmendi, sqarime shtesë dha Doruntinë Maloku, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Redon (Nuredin) Bajramit.

Pika e pestë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Afrim (Zenel) Mehmetit, Jakup (Ejup) Ismailit, Bajram (Ibish) Gashit dhe Jahi (Mejdi) Ramadanit.

Lidhur me këtë propozim-vendim, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku, drejtore.

Nora Klemendi tha se arsyetimi i këtij propozim-vendimi nuk përputhet me përgjigjen që është dhënë nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik, pasi që në vendim është cekur me destinim ndërtim, ndërsa Drejtoria e Planifikimit ka dhënë përgjigje për të gjitha parcelat me destinim infrastrukturë rrugore.

Lidhur me çështjen e ngritur nga znj. Kelmendi, sqarime shtesë dha Doruntinë Maloku, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Afrim (Zenel) Mehmetit, Jakup (Ejup) Ismailit, Bajram (Ibish) Gashit dhe Jahi (Mejdi) Ramadanit.

Pika e gjashtë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri (Rifat) Hoxhës dhe Besnik (Halit) Asllanit.

Arsyetimin për këtë pikë të rendit të ditës e paraqiti Doruntinë Maloku, drejtore.

Nora Kelmendi u shpreh se për parcelën kadastrale nr. 2724, destinimi ka qenë gjelbërim, sipërfaqe e vogël për shkollë e jo ndërtim, siç është cekur në vendim, ndërsa parcelat nr. 919, 920/2 dhe 921/2, destinimi është banim dhe rrugë e planifikuar, kurse në vendim ceket për ndërtim.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri (Rifat) Hoxhës dhe Besnik (Halit) Asllanit.

Pika e shtatë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Adem (Hazir) Berishës, Hetem (Hazir) Berishës, Fadil (Hazir) Berishës dhe Rustem (Hazir) Berishës.

Arsyetimin për këtë propozim-vendim e paraqiti Doruntinë Maloku, drejtore.

Nora Kelmendi, kërkoi që vendimi të ndryshohet dhe të jetë në bazë të certifikatës së pronës, pasi që si i tillë nuk mund të aprovohet. Gjithashtu, parcela nr. 36/0 ka destinim infrastrukturë rrugore dhe ndërtim, pra nuk e ka destinimin gjelbërim.

Lidhur me çështjen e ngritur nga znj. Kelmendi, sqarime shtesë dha Doruntinë Maloku, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Adem (Hazir) Berishës, Hetem (Hazir) Berishës, Fadil (Hazir) Berishës dhe Rrustem (Hazir) Berishës.

Pika e tetë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Qamil (Ismet) Bullatovcit, Agron (Ismet) Bullatovcit, Bajram (Muharrem) Bullatovcit dhe Bujar (Muharrem) Bullatovcit.

Arsyetimin për këtë propozim-vendim e paraqiti Doruntinë Maloku, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Qamil (Ismet) Bullatovcit, Agron (Ismet) Bullatovcit, Bajram (Muharrem) Bullatovcit dhe Bujar (Muharrem) Bullatovcit.

Pika e nëntë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Besim (Lika) Namanit, Naim (Isa) Berishës, Idriz (Halit) Blakçorit, Arsim (Esat) Blakçorit, Hajdin (Izmi) Berishës, Zenel (Izmi) Berishës, Zymer (Izmi) Berishës, Ilmi (Izmi) Berishës, Shaqir (Salih) Eminit, Milot (Isuf) Berishës, Fitim (Izmi) Berishës, Hatixhe (Bajram) Oranit, Neron (Isuf) Berishës, Alban (Feriz) Blakçorit, Florim (Omer) Gashit, Ilir (Omer) Gashit, Nazife (Bajram) Namanit dhe Shefkije (Bajram) Blakçorit.

Lidhur me këtë pikë të rendi të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i njoftoi Doruntinë Maloku, drejtore.

Nora Kelmendi tha se certifikata e pronës dhe kopja e planit për parcelën nr. 899/0, nuk është e bashkëngjitur në dokumentacion, andaj dhe është dashtë të jenë të bashkëngjitura në dokumentacion. Po ashtu, në certifikatat e pronës për parcelën nr. 1688/3 dhe për parcelën nr. 1688/5 janë shtatë qira mbajtës në kohë të caktuar, andaj kërkohet të dijë se a do të bartet e drejta e qirasë tek këta shtatë qirambajtës në këtë këmbim. Vërejtje tjetër është se mungon informacioni i shkresës nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik. Po ashtu, a janë këto prona komunale dhe të njëjtat a mund të këmbehen.

Duke pasur për bazë këto vërejtje dhe sugjerime, do të ishte mirë që të bëhen këto ndryshime, të rregullohen këto parcela, pastaj të na sillen në ndonjërin nga mbledhjet e radhës së Kuvendit, sepse konsideroi se është bërë shkelje, e kjo nuk mund të tolerohet nga ne.

Gëzim Sveçla kërkoi një përgjigje të qartë nga ekzekutivi lidhur me qirambajtësit, duke thënë se çka bëhet me këta qirambajtës, shtatë qirambajtës të cilët kanë të drejtën e qirambajtjes edhe atë pronë po e merr Komuna e Prishtinës. A ka ndonjë zyrtar kompetent që të përgjigjet në këtë pyetje?

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Doruntinë Maloku, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Besim (Lika) Namanit, Naim (Isa) Berishës, Idriz (Halit) Blakçorit, Arsim (Esat) Blakçorit, Hajdin (Izmi) Berishës, Zenel (Izmi) Berishës, Zymer (Izmi) Berishës, Ilmi (Izmi) Berishës, Shaqir (Salih) Eminit, Milot (Isuf) Berishës, Fitim (Izmi) Berishës, Hatixhe (Bajram) Oranit, Neron (Isuf) Berishës, Alban (Feriz) Blakçorit, Florim (Omer) Gashit, Ilir (Omer) Gashit, Nazife (Bajram) Namanit dhe Shefkije (Bajram) Blakçorit.

Pika e dhjetë

Propozim-vendimi për caktimin lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore "Pranvera shqiptare '81".

Arsyetimin për këtë pikë të rendit të ditës e paraqiti Mimoza Sylejmani, drejtore.

Nora Kelmendi kërkoi të dijë arsyen e mungesës së certifikatës së pronës dhe kopjes së planit të këtij propozim-vendimi.

Lidhur me çështjen e ngritura nga znj. Kelmendi, sqarime shtesë dha Mimoza Sylejmani, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 1 kundër, u miratua Vendimi për caktimin lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore "Pranvera shqiptare '81".

Pika e njëmbëdhjetë

Informatë për gjendjen në institucionet shëndetësore (QKMF, QMU, QMF).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Izet Sadiku, drejtor.

Violeta Salihu, fillimisht ngriti shqetësim rreth shkurtimit të orarit të punës në ambulancën në lagjen "Velania", ku ky shkurtim e ka rënduar orarin e ambulancave përreth. Lidhur me këtë raport tha se më vjen mirë që këto shërbimet shtëpiake janë duke u rritur dhe kjo është e dukshme në terren, mirëpo a ka bashkëpunim me Klinikën e Onkologjisë kur kemi

pacientë me sëmundje kronike, sidomos ata që janë në fazën terminale. Pra a kemi një statistikë se sa pacient kemi me kancer në këtë fazë?

Për shërbimin e EKG-së nëpër ambulanca, kemi vërejtje se ky shërbim nuk po bëhet mirë. Mendoj se kjo ka lidhje me një mungesë të trajnimit të stafit, që ndoshta do të duhej të shtohet tek mjekët familjarë nëpër ambulanca.

Ajo kërkoi të dijë se kur do të jetë funksional laboratorit në ambulancën në rrugën "Xhemail Ibishi".

Gëzim Sveçla tha se sa i përket mbylljes së ambulancës në lagjen "Velania" pas orës 15:00, konsideroj se nuk është zgjidhje, mendoj se është vetëm çështje e sistemit, mirëpo kjo bëhet në bashkëpunim edhe me Emergjencën, me memorandum bashkëpunimi, që personat të cilët nuk kanë nevojë për shërbime emergjente, mos me u ofruar ky shërbim dhe me u ofruar nëpër QMF-të ku gravitojnë, përkatësisht ku jetojnë.

Përderisa diskutohej pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës "Informatat për gjendjen në institucionet shëndetësore", anëtarët e GP të LVV-së e lëshuan mbledhjen.

Gresa Lahu tha se sa i përket çështjes së sistemit, unë kam punuar shumë gjatë me atë sistem. Është e qartë që ka probleme, bie sistemi, mirëpo mbi 15 minuta nuk bie, nga mbrëmja në mëngjes, nuk besoj që i është dashur dikujt të presë, por në ndërkohë, disa vite më herët, në Prishtinë ka funksionuar, dhe realiteti i kësaj është që në qoftë se një mjek e shënon një raport mjekësor bazë nga Mjekësia Familjare tek mjeku specialist në QKUK, ajo e referon.

Sami Boroci, theksoi se sa i përket sistemit të informatave shëndetësore, meqë jam edhe pjesë e asaj kompanie, atij sektori privat, problemi qëndron se, edhe pse nuk po jepet drita e gjelbër nga niveli qendror për me e realizuar këtë projekt, për shkak të arsyetimeve të ndryshme, e që nuk është dashtë sot me i komentuar, mirëpo një pjesë e asaj që kompania në fjalë bën në tregun amerikan e transformon me plot kuptimin e fjalës në shëndetësinë e Prishtinës.

Përparim Rama, kryetar, tha se aspekti i digjitalizimit është një çështje madhore, një çështje që do të na ndihmonte shumë. Unë si kryetar i Kryeqytetit faktikisht e kam ndie vetën të mburrur që një kompani e tillë me mundësi të mëdha, na ka ofruar shërbime të tilla dhe në kryeqytet. I bëjë ftesë kësaj kompanie që të vazhdojmë bashkëpunimin, nëse është e mundur, edhe pse nuk vërej asnjë arsyetim se pse nuk mundemi ne këtë sistem me ia ofruar sot kryeqytetit edhe me i digjitalizuar të gjitha proceset.

Lidhur me pyetjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha Izet Sadiku, drejtor.

U konstatua se u përkrah Informatat për gjendjen në institucionet shëndetësore (QKMF, QMU, QMF).

Informatën lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2023-2024.

Lidhur me Informatën për përgatitjen e fillimit të vitit të ri shkollor 2023-2024, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Besianë Musmurati, drejtoare. Ajo tha se ka qenë një vit me shumë punime, të cilat i kemi bërë për përgatitje të vitit të ri shkollor. Kemi rinovuar për herë të parë në historinë e Komunës të Prishtinës 6 shkolla në tërësi, si dhe rreth 22 shkolla të tjera të cilat kanë pasur renovime të pjesërishtme. Gjithashtu kemi bërë ristrukturimin e shkollave, kemi filluar ndërtimin e shkollave, disa çerdheve etj.

Ajet Brajšori e përgëzoi Drejtorinë e Arsimit për informatën e dhënë. Lidhur me këtë tha se ne do të përqendrohemi në katër fokuse, të cilat besoj se në një të ardhshme t'i kemi parasysh se si me i mbajtur shkollat tona në një rrjedhë normale të procesit mësimor. Si çështje e parë që do ta kemi parasysh, do të jetë Plani i veprimit për siguri. Çështje e dytë e që nuk është në kompetencë e Drejtorisë, është pajisja e nxënësve me tekste mësimore. Çështje e tretë do të jetë furnizimi i shkollave me material didaktik dhe higjienik. Fokusi i katërt është pikërisht në stafin teknik, gjendja me stafin teknik nëpër shkolla.

U konstatua se u përkrah Informata lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2023-2024.

Pika e trembëdhjetë

Propozim-vendimin për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Besianë Musmurati, drejtoare.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimin për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës.

Pika e katërbëdhjetë

Raportimi i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronave komunale për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023.

Përparim Rama, kryetar, i informoi të pranishmit për kontratat e shfrytëzimit të pronave komunale për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, i cili tha se në seancën e radhës në Kuvend do ta sjellim për votim Rregulloren për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për afat deri 1 vit. Kjo rregullore do t'i lehtësojë procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale dhe natyrisht do të krijojë të hyra të reja të Kryeqytetit.

Ai tha se para se t'ju informoj për kontratat valide që ka kryeqyteti me organizata, institucione e palë të ndryshme për shfrytëzimin e pronës komunale, dua të shpreh kënaqësinë për shfrytëzimin e pronës komunale të ndryshme, po ashtu që vazhdojmë të jemi krejtësisht transparent në kontekst të informimit të qytetarëve dhe publikimit të listës së përgjithshme të pronave në faqen tonë zyrtare.

Faqe 1 nga 12

Komisionet që i kemi themeluar për verifikimin e shfrytëzimit të pronës komunale, i kanë kryer punët e tyre dhe të gjitha rekomandimet që i kanë dhënë, janë miratuar nga asambleja e Kryeqytetit në formë vendimesh për pronat komunale që shfrytëzohen në Zonën Industriale, banesat në lagjen "Bregu i Diellit", në Fushën e Pajtimit dhe në Hajvali. Po ashtu, edhe për kontratat e tjera të shfrytëzimit të pronës komunale, siç janë: çështja e parkingut në SHSKUK dhe Qendra Kardiale e Kosovës dhe kontratat e fushave të tjera. Njëherësh bëri të ditur se është nënshkruar edhe aneks-kontrata për parkingje etj.

U konstatua se u përkrah Raportimi i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronave komunale për gjashtë mujorin e parë të vitit 2023.

**Pika e pesëmbëdhjetë
Pyetje dhe përgjigje**

Granit Geci, për Kryetarin e Komunës:

- Gjendja e Tregut të gjelbër në lagjen "Ulpiana", është shumë e rënduar, Përveç pamjes jo të mirë, aty është rrezik edhe për ndonjë sëmundje apo epidemi. A mendohet të bëhet diçka konkrete për rregullimin e këtij tregu?

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Geci, përgjigje dha Përparim Rama, kryetar.

Sami Salihu, për Kryetarin e Komunës:

- Marrëveshja e cila është në mes të Ndërmarrjes Publike Banesore dhe Komunës për kryerjen e punëve të ndryshme fizike nuk ka rezultuar e mirë, andaj do të ishte mirë që kjo marrëveshje të jetë në nivelin e duhur dhe punët fizike të kryhen ashtu siç parashihet me marrëveshje.

Lidhur me pyetjen e z. Salihu, përgjigje dha Përparim Rama, kryetar.

Mbledhja përfundoi në orën 17:15

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvëndit
Pëllumb Bajcinovci**



Faqe12nga12